



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 3 qershor 2024
Nr.:ref.: RK 2442/24

VENDIM PËR TËRHEQJE TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI47/23

Parashtrues

Nebih Dedinca

Vlerësim i kërkesës së parashtruesit ë kërkesës për tërheqjen e kërkesës, me të cilën ka kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit AC.nr.1616/2021 të 23 shtatorit 2022 të Gjykatës së Apelit

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Nebih Dedinca nga fshati Leshkoshiq, komuna Fushë Kosovë, (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga Jeton Osmani, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [AC.nr.1616/2021] e 23 shtatorit 2022 të Gjykatës së Apelit.
3. Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës, më 19 tetor 2022.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kërkesës së parashtruesit të kërkesës për tërheqjen e kërkesës, nëpërmjet se cilës i njëjti ka kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit, me pretendimin se i njëjti ka shkelur të drejtën e tij të garantuar me nenin 3 [Barazia para Ligjit], në lidhje me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe neni 6 [E drejta për një proces të rregullt] dhe 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).
6. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 01/2023 u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata) i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur, e cila ka shfuqizuar Rregulloren e punës së Gjykatës nr. 01/2018. Lidhur me këtë, konform rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 18 shkurt 2023, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në njërin nga filialet e Postës së Kosovës, e cila në Gjykatë arriti dhe u regjistrua më 23 shkurt 2023.
8. Më 2 mars 2023, Gjykata njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Gjithashtu nga Gjykata Themelore në Prishtinë, Gjykata kërkoi si dëshmi fletëkthesën për të konfirmuar datën e pranimit të Aktgjykimit të kontestuar nga parashtruesi i kërkesës. Të njejtën datë, një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës së Apelit.
9. Më 3 mars 2023, Gjykata Themelore në Prishtinë dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën e cila konfirmon se Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 18 tetor 2022.
10. Më 7 mars 2023, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin GJR.KI47/23, caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues dhe me Vendimin KSH.KI47/23 emëroi anëtarët e

Kolegjit shqyrtues në përbërje të gjyqtareve: Selvete Gërzhaliu-Krasniqi (kryesuese), Nexhmi Rexhepi dhe Enver Peci (anëtar).

11. Më 26 janar 2024, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dorëzoi në Gjykatë kërkesë për tërheqje të shqyrtimit të lëndës KI47/23, nëpërmjet së cilës njofton Gjykatën se parashtruesi i kërkesës me vetë dëshirë heqë dorë nga kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [AC.nr.1616/2021] të 23 shtatorit 2022 të Gjykatës së Apelit.
12. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
13. Më 29 prill 2024, pasi shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës miratimin e kërkesës për tërheqje të kërkesës së parashtruesit të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Bazuar në shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës ka punuar në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK) dhe pasi kishte arritur moshën e pensionimit, kishte parashtruar kërkesë pranë organeve kompetente të KEK-ut për njohjen e shpërblimit të pagave jubilarë, pasi kishte mbushur tridhjetë (30) vjet të përvojës së punës, të cilën kërkesë KEK-u e kishte refuzuar. Si rezultat, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar kërkesëpadi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, e cila kishte aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e tij. Në anën tjetër, kundër Aktgjykimit [C.nr.4825/2020] të Gjykatës Themelore në Prishtinë, KEK-u kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, e cila nëpërmjet Aktgjykimit [AC.nr.1616/2021] të 23 shtatorit 2022, e kishte aprovuar ankesën e KEK-ut, si dhe kishte ndryshuar Aktgjykimin [C.nr.4825/2020] e Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke e refuzuar në tersi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës. Kundër aktgjykimi të lartcekur të Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës nëpërmjet Zyrës së Kryeprokurorit të shtetit kishte parashtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, e cila iu refuzua me arsyetimin se nuk kishte bazë për ngritjen e saj në Gjykatën Supreme.

Kërkesa për tërheqjen e lëndës

15. Më 26 janar 2024, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës në Gjykatë dorëzoi kërkesë për tërheqje të shqyrtimit të lëndës KI47/23, e cila ndër të tjera thekson: *“Padiësi ka paraqitur pranë Gjykatës Kushtetuese kërkesën me numër KI47/23 ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, AC.nr.1616/2021, dt.23.09.2022 që ka vendosur me padinë e paraqitur ndaj KEK sh.a, për njohjen e pagave jubilarë. Padiësi njofton Gjykatën se e tërheq kërkesën e tij, ndaj aktgjykimeve të lartcekura lidhur me padinë ndaj KEK. sh.a me vullnetin e tij të plotë për arsye të veta personale dhe kjo pasi që i njëjti do ta realizojë të drejtën e pagesës së pagave jubilarë ne rrugë jashtëgjyqësore. Andaj me qellim të arritjes së një marrëveshje ... me të paditurën rreth realizimit të kompensimit të pagave jubilarë në rrugë jashtëgjyqësore padiësi e tërheq kërkesën e tij me numër lëndor KI47/23 që ka të bëjë me padinë e tij numër lëndor C.nr.4825/19.”*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës për tërheqje të kërkesës

16. Në vlerësimin e pranueshmërisë së kërkesës, Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i përmbush kriteret e përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara me tej me Rregullore të punës.

17. Në rrethanat e rastit konkret, duke marrë parasysh kërkesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata se pari do e shqyrtojë kërkesën e tij për tërheqje të kërkesës, dhe në lidhje me këtë i referohet nenit 23 të Ligjit dhe rregullit 31 të Rregullores së punës:

Neni 23
[Tërheqja e palës]

“Gjykata Kushtetuese do të vendosë për çështjet që u janë referuar në mënyrë ligjore nga ana e palëve të autorizuar pavarësisht tërheqjes së palës nga procedura”.

Rregulli 31
(Tërheqja e palëve nga procedura)

“(1) Parashtruesi/ja e kërkesës mund të tërheqë kërkesën në çdo kohë para shqyrtimit dhe vendimmarrjes së Gjykatës.

(2) Pavarësisht tërheqjes së kërkesës, Gjykata mund të vazhdojë me shqyrtimin dhe vendosjen e kërkesës kur këtë e kërkon interesi publik dhe/ose respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë.”

18. Gjykata vëren që paragrafi (1) i rregullit 31 të Rregullores së punës, i mundëson parashtruesve të kërkesave që të tërheqin kërkesën e tyre (i) para fillimit të seancës shqyrtuese, ose (ii) para marrjes së vendimit nga ana e Gjykatës. Gjykata në bazë të nenit 23 të Ligjit dhe paragrafit (2) të rregullit 31 të Rregullores së punës, vendos për miratimin ose jo të kësaj kërkesë.
19. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata duke pas parasysh natyrën e kontestit që është kompensimi i pagave jubilarë nga ana e KEK-ut, dhe dakordimin e palëve që ky kontest të zgjidhet mes tyre, vlerëson se nuk ka ndonjë arsye bindëse për të vazhduar tutje me shqyrtimin e kërkesës KI47/23 të parashtruesit të kërkesës (shih, në lidhje me këtë, rastet e Gjykatës [KI04/17](#), parashtrues Z. K, Vendim për tërheqje të kërkesës, i 28 korrikut 2017, paragrafi 19; rastin [KI110/17](#), parashtrues *Sekule Stanković*, Vendimi i 13 qershorit 2018, paragrafi 18; [KI199/21](#) dhe [KI200/21](#), parashtrues *Gordana Aksić dhe Zvonimir Stanimirović*, Vendimi i 7 shkurtit 2022, paragrafi 17, dhe rastin [KI95/22](#), parashtrues *Habibe Elezi*, Vendimi i 27 tetorit 2022, paragrafi 20).
20. Rrjedhimisht, Gjykata miraton kërkesën e parashtruesit të kërkesës për tërheqjen e kërkesës në pajtim me nenin 23 të Ligjit dhe rregullin 31 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, nenin 23 të Ligjit dhe rregullin 31 të Rregullores së punës, më 29 prill 2024, njëzëri:

VENDOS


- I. TË MIRATOJË kërkesën për tërheqjen e kërkesës;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 4 të nenin 20 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes së tij në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues


Bajram Ljatifi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani